

UNION BANK SH.A.

**Raporti i Auditorit te Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare per
vite e mbyllur me 31 dhjetor 2010**

PERMBAJTJA

	FAQJA
RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR	3
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA PERMBLEDHESE E TE ARDHURAVE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN AKSIONAR	6
PASQYRA E RRJEDHES SE PARASE	7
SHENIME PER PASQYRAT FINANICARE	8-53

RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR

Aksionereve dhe drejtuesve të Union Bank sh.a.:

Raporti mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Union Bank sh.a. ("Banka"), bashkangjitur, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2010, pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave, të ndryshimeve në kapitalin aksionar, të rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të parimeve bazë kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi i Bankës është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për kontrollin e brendshëm i cili në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar mbi auditimin tonë. Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të përftojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për vlerat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Proçedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë dhe vlerësimin e rrezikut të ekzistencës të pasaktësive në pasqyrat financiare, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të Shoqërisë, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2010, rezultatit financiar dhe ndryshimet në rrjedhjen e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.




30 mars 2011
Tiranë, Shqipëri

Union Bank sh.a
Pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2010

(Te gjitha vlerat jane shprehur ne mije Lek, pervecse kur shprehet ndryshe)

	Shenime	31 dhjetor 2010	31 dhjetor 2009
Aktivet			
Arka dhe llogari me Banken Qendrore	5	2,584,238	2,346,737
Depozita dhe llogari me bankat	6	4,273,041	1,862,149
Investimeve afatshkurtra ne letra me vlere	7	1,882,550	1,860,481
Hua dhe paradhenie per klientet, neto	8	10,351,805	9,829,680
Aktive te patrupezuara, neto	9	78,546	97,997
Aktive te trupezuar, neto	10	224,179	252,592
Aktive te mbajtura per shitje	11	29,397	29,397
Investimeve afatgjata ne letra me vlere	12	1,855,210	169,987
Aktive te tjera	13	46,932	266,290
Aktive tatimore te shtyra	27	17,789	28,212
Totali i aktiveve		21,343,687	16,743,522
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	14	2,454,160	1,827,327
Detyrime ndaj klienteve	15	16,857,231	12,747,859
Detyrime te tjera	16	73,666	286,195
Detyrime tatimore te shtyra	27	20,060	-
Totali i detyrimeve		19,405,117	14,861,381
Borxhi i varur	17	1,041	1,035
Kapitali			
Kapitali aksionar	18	2,049,331	2,049,331
Primit e aksionarëve		175,600	175,600
Humbja e mbartur		(287,402)	(343,825)
Totali i kapitalit		1,937,529	1,881,106
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		21,343,687	16,743,522

Keto pasqyra financiare u miratuan nga Drejtuesit Ekzekutive te Bankes me 17 mars 2011 dhe u nenshkruan ne emer te tyre nga:


 Gazmend Kadriu
 Drejtor i pergjithshem




 Adela Haxhiu
 Drejtore e kontabilitetit

Pasqyra e pozicionit financiar duhet te lexohet se bashku me shenimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 8 deri ne faqen 53, te cilat jane pjese perberese e pasqrave financiare.

Union Bank sh.a**Pasqyra permbledhese e te ardhurave per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2010***(Te gjitha vlerat jane shprehur ne mije Lek, pervecse kur shprehet ndryshe)*

	Shenime	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2010	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2009
Te ardhura nga interesat	19	1,324,381	970,291
Shpenzime per interesat	20	(677,880)	(463,853)
Te ardhura neto nga interesat		646,501	506,438
Te ardhura nga komisionet	21	145,785	141,608
Shpenzime per komisionet	22	(28,871)	(37,663)
Te ardhura neto nga komisionet		116,914	103,945
Fitimi neto nga kurset e kembimit	23	108,815	306,674
Te ardhura te tjera, neto		524	1,638
		109,339	308,312
E ardhura operative		872,754	918,695
Provigjione per humbje nga huate dhe paradheniet	8	(85,213)	(153,905)
Shpenzime per provigjione te tjera	24	-	(36,572)
Amortizimi i aktiveve te patrupezuara	9	(24,115)	(30,721)
Zhvleresimi i aktiveve te trupezura	10	(48,434)	(55,421)
Shpenzime personeli	25	(261,958)	(230,747)
Shpenzime te tjera administrative	26	(366,128)	(293,869)
Totali i shpenzimeve operacionale		(785,848)	(801,235)
Fitimi para tatimit		86,906	117,460
Tatimi mbi fitimin	27	(30,483)	(328)
Fitimi i vitit		56,423	117,132
Te ardhura te tjera te pergjithshme		-	-
Totali i te ardhura te tjera te permbledhese per vitin		56,423	117,132

Pasqyra permbledhese e te ardhurave dhe shpenzimeve duhet te lexohet se bashku me shenimet per pasqyrat financiare nga faqja 8 deri ne faqen 53, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Union Bank sh.a**Pasqyra e ndryshimeve ne kapitalin aksionar per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2010***(Te gjitha vlerat jane shprehur ne mije Lek, pervecse kur shprehet ndryshe)*

	Kapitali aksionar	Primi i aksioneve	Humbja e akumuluar	Totali
Gjendja me 1 janar, 2009	1,557,305	175,600	(460,957)	1,271,948
Primet e aksioneve	-	-	-	-
Rritja e kapitalit	492,026	-	-	492,026
Totali i te ardhurave te pergjithshme per vitin	-	-	117,132	117,132
Gjendja me 31 dhjetor 2009	2,049,331	175,600	(343,825)	1,881,106
Primet e aksioneve	-	-	-	-
Rritja e kapitalit	-	-	-	-
Totali i te ardhurave te pergjithshme per vitin	-	-	56,423	56,423
Gjendja me 31 dhjetor 2010	2,049,331	175,600	(287,402)	1,937,529

Pasqyra e ndryshimeve ne kapitalin aksionar duhet te lexohet se bashku me shenimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 8 deri ne faqen 53, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Union Bank sh.a
Pasqyra e fluksit te parase per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2010
(Te gjitha vlerat jane shprehur ne mije Lek, pervecse kur shprehet ndryshe)

Shenime	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2010	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2009
Rrjedha e parase nga operacionet:		
Fitimi para tatimit	86,906	117,460
Rregullime per te kuadruar rezultatin neto me rrjedhjen neto te aktiveve monetare nga veprimtarite operative:		
Te ardhura nga interesi	(1,324,381)	(970,291)
Shpenzime interesi	677,880	463,853
Zhvleresimi i aktiveve te trupezuara	48,434	55,421
Amortizimi i aktiveve te patrupezuara	24,115	30,721
Humbje neto nga zhvleresimi i kredive	85,213	153,905
Efekti i rivleresimit te parase dhe ekuivalenteve te saj	(77,281)	(350,621)
Efekti i rivleresimit te borxhit te varur	6	-
Shpenzime per provigjione te tjera	-	36,572
	(479,108)	(462,980)
Ndryshim ne aktivet operative:		
Rritje ne depozita dhe llogari me bankat	(654,701)	(270,216)
Rritje ne hua dhe paradhenie per klientet	(550,200)	(3,505,069)
Ulje/(rritje) e aktiveve te tjera	219,358	(19,601)
Ndryshim ne detyrimet operative:		
Rritje e detyrimeve ndaj bankave dhe institucioneve financiare	618,401	674,388
Rritje e detyrimeve ndaj klienteve	4,015,528	2,764,674
(Ulje)/ rritje e detyrimeve te tjera	(212,529)	39,552
	3,435,857	(316,272)
Interesi i marre	1,233,239	883,056
Interesi i paguar	(575,603)	(401,547)
Paraja e gjeneruar /(perdorur) nga aktiviteti operativ	3,614,385	(297,743)
Rrjedha e parase nga veprimtarite investuese:		
Blerja e aktiveve te patrupezuara	9 (4,664)	(1,706)
Blerja e aktiveve te trupezuara	10 (22,890)	(41,648)
Blerja e aktiveve te mbajtura per shitje	-	(29,397)
Shitja e aktiveve te trupezuara	2,869	37
Shitja/ (blerja) e letrave me vlere te investimit afatshkurtra	163,857	(1,127,669)
(Blerja)/ shitja e letrave me vlere te investimit afatgjata	(1,653,161)	100,000
Paraja e perdorur per aktivitetet investuese	(1,513,989)	(1,100,383)
Rrjedha e parase nga veprimtarite investuese:		
Borxhi i varur	-	-
Rritja ne kapitalin e paguar	-	121,661
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet investuese	-	121,661
Rritja / (zvogelimi) neto ne para dhe ekuivalentet e saj	2,100,396	(1,276,465)
Paraja dhe ekuivalentet e saj ne fillim te vitit	28 3,243,032	4,168,876
Efekti i rivleresimit te parase dhe ekuivalenteve te saj	77,281	350,621
Paraja dhe ekuivalentet e saj ne fund te vitit	28 5,420,709	3,243,032

Pasqyra e rrjedhes se parase duhet te lexohet se bashku me shenimet per pasqyrat financiare nga faqja 8 deri ne faqen 53, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

1. HYRJE

Union Bank Sh.a. ("Banka") eshte nje institucion financiar i regjistruar si banke tregtare me 9 janar 2006 bazuar ne Vendimin nr. 101, date 28 dhjetor 2005 te Bordit Mbikqyres se Bankes se Shqiperise. Aktiviteti i bankes i nenshtrohet Ligjit nr. 8269 date 23 dhjetor 1997 "Per Banken e Shqiperise", Ligjit nr.9662 date 18 dhjetor 2006 si dhe ne perputhje me te gjitha rregullat dhe rregulloret e aprovuara nga Keshilli Mbikqyres i Bankes se Shqiperise.

Aksioneret e Bankes jane: Unioni Financiar Tirane Sh.p.k, Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim (BERZH), Edmond Leka dhe Niko Leka perkatesisht me nga 83.12%, 12.5%, 2.19% and 2.19% te aksioneve.

Banka eshte nje banke tregtare, e cila ofron sherbime bankare per individe dhe kompani ne Republiken e Shqiperise. Banka eshte regjistruar si person juridik me numer regjistrimi 33563 date 26 maj 2005, date ne te cilen Banka filloi aktivitetin e saj tregtar. Banka mori licencen per aktivite bankare me 9 janar 2006.

Selia Qendrore e Bankes ndodhet ne Tirane, Shqiperi. Me 31 dhjetor 2010 Banka kishte 257 punonjes (2009: 236).

Drejtuesit dhe administrimi i Bankes me 31 dhjetor 2010

Bordi Drejtues (Keshilli mbikqyres)

Edmond Leka	Kryetar
Niko Leka	Zv.Kryetar
Varuzhan Piranian	Anetar
Agim Xhaja	Anetar
Gazmend Kadriu	Anetar
Daniel Berg	Anetar
Genc Turku	Anetar

Komiteti i Kontrollit

Varuzhan Piranian	Kryetar
Mirela Lika	Anetar
Erton Kaleshi	Anetar

Drejtimi Ekzekutiv

Gazmend Kadriu	Drejtor i Pergjithshem
Suela Bokshi	Drejtor Operacional
Ardian Petollari	Drejtor i Divizionit te Biznesit

2. BAZA E PERGATITJES

2.1 Deklarata e perputhshmerise

Pasqyrat financiare te Bankes jane pergatitur ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF), dhe interpretimet ne fuqi te Bordit te Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit (BSNK).

2.2 Baza e pergatitjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur mbi bazen e kostos historike pervec:

- instrumentat financiare derivative vleresohen mbi bazen e vleres se tregut
- instrumentat financiare te matura me vleren e tregut nepermjet fitim humbjes qe vleresohen mbi bazen e vleres se tregut
- letrave me vlere te disponueshme per shitje qe vleresohen mbi bazen e vleres se tregut

2. BAZAT E PERGATITJES (VAZHDIM)

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare jane paraqitur ne Leke Shqiptar (LEK), e cila eshte edhe monedha funksionale e Bankes. Pevce rasteve kur specifikohet ndryshe, informacioni financiar eshte paraqitur ne LEK dhe eshte i rumbullakosur ne mijeshen me te afert.

2.4 Perdorimi i vleresimeve dhe gjykimeve

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon qe Drejtimi te beje gjykime, vleresime dhe supozime rreth aplikimit te politikave kontabel dhe vlerave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto vleresime.

Vleresimet dhe supozimet e lidhura me to rishikohen vazhdimisht. Rishikimet ndaj vleresimeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen ndodh rishikimi dhe periudhat e ardhshme ne rast se ky ndikon ne periudhat aktuale dhe ato te pritshme.

Ne vecanti, informacioni rreth burimeve kryesore te pasigurise se vleresimeve dhe gjykimeve kontabel aplikimin e politikave kontabel te Bankes, qe kane efekt te rendesishem ne shumate e njohura ne pasqyrat financiare jane pershkruar ne shenimin 4.

3. PERMBLEDHJE E PARIMEVE KRYESORE KONTABEL

Politikat e kontabilitetit te Bankes jane aplikuar ne menyre konsistente gjate gjithe periudhave te raportimit te paraqitura ne keto pasqyra financiare.

3.1 Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj jane regjistruar me kursin e kembimit te dites se transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare te shprehura ne monedhe te huaj jane kembyer me kursin e kembimit ne daten e bilancit. Diferencat qe rrjedhin nga ndryshimi i kursit te kembimit jane njohur ne pasqyren permbledhese te te ardhurave. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare ne monedhe te huaj mbahen me kosto historike ne Lek me kursin e kembimit ne daten e kryerjes se transaksionit.

Kurset e kembimit te zbatuara per monedhat kryesore ne daten 31 dhjetor 2010 dhe 31 dhjetor 2009 jane si me poshte:

	2010	2009
EUR:LEK	138.77	137.96
USD:LEK	104	95.81
EUR:USD	1.334	1.440

3. PERMBLEDHJE E PARIMEVE KONTABEL ME TE RENDESISHME (VAZHDIM)

3.2 Instrumentat financiare

i. Klasifikimi

Huate dhe Llogarite e Arketueshme perbehen nga huate dhe paradheniet ndaj klienteve, institucioneve financiare dhe hua punonjësve.

Aktivet e mbajtura ne maturim jane mjete financiare me pagesa fikse dhe maturim te percaktuar, per te cilat Banka ka per qellim dhe mundesi t'i mbaje deri ne maturim.

ii. Njohja

Aktivet e mbajtura ne maturim, huate dhe llogarite e arketueshme regjistrohen ne ditën kur Banka disburson vleren monetare te tyre

iii. Matja

Instrumentat Financiare maten me koston fillestare, duke perfshire dhe koston e transaksionit. Te gjitha kredite e disbursuara, llogarite e arketueshme si dhe aktivet e mbajtura ne maturim maten me koston e amortizuar minus humbjen nga zhvleresimet ne qofte se ka. Kosto e amortizuar llogaritet duke perdorur metoden e normes efektive te interesit. Primet dhe zbritjet, bashke me koston fillestare te transaksionit, jane te perfshira ne vlerat e mbajtura te instrumentave perkatese dhe amortizohen duke u bazuar ne normen efektive te interesit te instrumentit, atehere kur eshte e zbatueshme.

iv. Instrumenta te vecanta

Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e saj perbehen nga balancat e parave ne arke, ato te depozituara ne Banken Qendrore si dhe investimet likuide afatshkurtra me afat maturimi tre-mujor ose me pak.

Bonot e thesarit te mbajtura ne maturim

Bonot e thesarit konsiderohen si investime te mbajtura deri ne maturitet persa kohe qe Banka ka qellimin dhe mundesine t'a beje kete.

Letrat me vlere te investimit te mbajtura ne maturim

Investimet e letrave me vlere te mbajtura ne maturim jane investime hua te cilat Banka ka qellimin dhe mundesine t'i mbaje deri ne maturitet. Si rezultat ato klasifikohen si aktive te mbajtura ne maturim.

Huate dhe paradheniet dhene klienteve dhe institucioneve financiare

Huate dhe paradheniet e leshuara nga Banka klasifikohen si hua dhe llogari te arketueshme te leshuara. Huate ose kredite raportohen per vlere neto duke zbritur provigjonet per zhdemtimin e kredive ne menyre qe te reflektohen shumat e rikuperueshme (referohu tek politikat kontabel (vi)).

v. Mosnjohja

Mosnjohja e nje mjeti financiar te aktivitetit ndodh atehere kur Banka e humb kontrollin mbi te drejten kontraktuale qe perben kete mjet. Kjo ndodh ne momentin kur keto te drejta jane permbushur, kane skaduar ose jane dorezuar. Mosnjohja e nje detyrimi financiar ndodh kur ky pushon se qeni i tille. Banka perdor metoda specifike identifikimi per te percaktuar nese ka realizuar fitim apo humbje nga mosnjohja. Mosnjohja e huave dhe llogarive te arketueshme behet atehere kur Bankes i paguhet huaja.

3. PERMBLEDHJE E PARIMEVE KONTABEL ME TE RENDESISHME (VAZHDIM)

3.2 Instrumentat financiare (vazhdim)

vi. Zhvleresimi dhe mosarketimi i aktiveve financiare

Ne cdo date te pergatitjes se pasqyrave financiare behet vleresimi per te percaktuar nese ekziston evidence e mjaftueshme qe nje mjet financiar ose grup mjetesh te mund te jete zhvleresuar. Ne qofte se ka nje evidence te tille, percaktohet vlera e arketueshme dhe shuma e zhvleresimit bazuar ne vleren neto aktuale te pagesave te pritshme ne te ardhmen, si dhe behet njohja e diferences midis shumes se arketueshme dhe balances se mbetur si vijon.

Ne cdo date te pergatitjes se pasqyrave financiare Banka vlereson nese ekziston evidence e mjaftueshme qe nje mjet financiar ose grup mjetesh eshte zhvleresuar. Nje aktiv financiar apo nje grup i tille eshte zhvleresuar vetem nese ekziston nje evidence objektive zhvleresimi si nje rezultat i nje apo disa ngjarjeve te ndodhura pas njohjes fillestare te aktivitetit, dhe kjo (keto) ngjarje ka nje impakt ne flukset e pritshme te te ardhurave per kete aktiv apo grup aktivesh financiare te cilat mund te vleresohen me besueshmeri.

Kriteret qe Banka perdor per te percaktuar nese ekziston evidence objektive zhvleresimi perfaqshijne:

- Mosrespektim i kontrates per pagesat me vonese te principalit dhe te interesit;
- Veshitresi te hasura nga huamarresi ne flukset e mjeteve monetare;
- Mosrespektim i kushteve te kontrates se kredise;
- Fillimi i procedurave te falimentimit
- Perkeqesim i pozites konkurruese te huamarresit
- Perkeqesim ne vleren e kolateralit

Banka se pari kontrollon nese ekziston nje evidence objektive zhvleresimi per aktivet financiare qe jane individualisht te konsiderueshem. Nese Banka ve re se nuk ka nje evidence objektive zhvleresimi per aktivet individualisht te konsiderueshem, nese jane te konsiderueshem ose jo, i perfshin ato ne grupin e aktiveve me karakteristika rreziku te ngjashme me to dhe po ne grup i vlereson ato per zhvleresim. Aktivitetet qe jane testuar per zhvleresim individual dhe per to eshte njohur nje humbje nga ky zhvleresim, nuk perfaqshihen ne nje vleresim grupi per zhvleresim.

Vlera e zhvleresimit percaktohet si diference midis vleres kontabel dhe vleres aktuale te pagesave te pritshme ne te ardhmen skontuar me normen fillestare te interest efektiv. Llogaritja e vleres aktuale te pagesave te pritshme te aktiveve financiare te kolateralizuara reflekton pagesat e pritshme qe mund te rezultojne nga ekzekutimi i kolateralit pakesuar me kostot e shitjes se kolateralit. Per qellime te nje vleresimi ne grup per zhvleresim, aktivet financiare grupohen ne baze te karakteristikave te ngjashme te rrezikut te kredise (lloji dhe vlera e kredise). Banka vendosi te zbatoje modelin “roll rate” per te identifikuar humbjet e vleresuara te pritshme te kredise ne cdo grup. Portofoli ne cdo grup eshte ndare me tej ne shporta vonesash dhe jane llogaritur normat mujore te rrjedhjes nga nje shporte vonesash ne ate pasardhese. Performanca e portofolit u analizua per disa muaj per te arritur ne nje faktor mesatar humbjeje, i cili me pas u zbatua per te vleresuar zhvleresimin per cdo grup.

Kur nje kredi vleresohet si e pa-mbledhshme, ajo crregjistrohet kundrejt provigjionit perkates te percaktuar per zhvleresimin e kredise. Hua te tilla fshihen pasi qe jane ndermarre dhe kryer te gjitha procedurat e nevojshme dhe jane percaktuar shumet e humbjes. Rikuperimet te cilat pasojne shumet qe jane fshire paraprkasht kreditohen ne Pasqyren e Fitim Humbjes tek zeri “Ripagime nga kredi te fshira”.

Ne qofte se shumet per provigjione per zhvleresimin e kredive ulen per shkak te nje ngjarjeje qe ndodh pas fshirjes, clirimi i provigjioneve kreditohet ndaj provigjioneve per zhvleresim kredish ne pasqyren e te ardhurave.

3. PERMBLEDHJE E PARIMEVE KONTABEL ME TE RENDESISHME (VAZHDIM)

3.2 Instrumentat financiare (vazhdim)

vi. *Zhvleresimi dhe mosarketimi i aktiveve financiare (vazhdim)*

Per Aktive financiare te mbajtura deri ne maturim – vlera kontabel e ketyre aktiveve zvogelohet me shumet e vleresuara te rikuperueshme nepermjet nje llogarie provigjioni, vlera e humbjes do te perfshihet ne pasqyren permbledhese te te ardhurave.

3.3 Marreveshjet e riblerjes

Kur instrumentet e borxhit jane shitur nen nje premtim riblerje me nje cmim te paravendosur, ato qendrojne ne bilanc dhe vlera monetare e marre regjistrohet nen zerin “ Hua dhe paradhenie nga institucionet financiare”. Ne anen tjetere, instrumentet e borxhit qe jane blere nen premtimin per t’i rishitur nuk njihen ne bilanc dhe vlera monetare e paguar eshte regjistruar nen “Hua dhe paradhenie dhene institucioneve financiare”.

3.4 Aktive te qendrueshme te patrupezuara

Aktivet e patrupezuara te blera nga Banka shprehen me kosto duke i zbritur amortizimin e akumuluar. Programet kompjuterike amortizohen sipas metodese vlerese se mbetur me norme vjetore amortizimi 25%. Aktive te tjera patrupezuara amortizohen sipas metodese lineare me norme vjetore amortizimi 15%.

3.5 Aktive te qendrueshme te trupezuara

Aktivet e qendrueshme te trupezuar jane te shprehura me kosto duke i zbritur zhvleresimin e akumuluar. Zhvleresimi i vitit eshte llogaritur sipas metodese vlerese se mbetur ne perputhje me normat e meposhtme:

	Normat vjetore
Paisje kompjuterike	25%
Paisje zyre	20%
Paisje elektronike dhe elektrike	20%
Instalime	20%

3.6 Aktivet afatgjata te mbajtura per shitje

Aktivet afatgjata dhe grupet e nxjerra jashte perdorimit klasifikohen si te mbajtura per shitje nese vlera e tyre kontabel neto do te rifitohet parimisht nepermjet nje transakcioni shitjeje ne vend te perdorimit te vazhdueshem. Ky kusht konsiderohet i plotesuar nese shitja e tij eshte me probabilitet te larte dhe eshte i pershtatshem per shitje te menjehershme ne kushtet e tij aktuale. Drejtimi i Bankes duhet te jete i angazhuar ne nje plan per te shitur aktivin, i cili pritet qe te kualifikohet si shitje e perfunduar brenda nje viti nga data e klasifikimit.

Aktivet afatgjata te mbajtura per shitje maten me vleren me te ulet mes vlerese se tyre kontabel neto dhe vlerese se drejte minus kostot per shitje.

3. PERMBLEDHJE E PARIMEVE KONTABEL ME TE RENDESISHME (VAZHDIM)

3.7 Njohja e te ardhurave

Te ardhurat dhe shpenzimet per interesa per te gjitha instrumentat qe mbartin interes, jane njohur ne pasqyren e te ardhurave sipas parimit te drejtave te konstatuara duke perdorur metoden e normes efektive te interesit. Te ardhurat nga interesat perfshijne kuponat e fituar mbi investimet me te ardhura fikse dhe amortizohet nga skonto apo primet mbi bonot e thesarit.

Kur nje kredi behet e dyshimte per tu arketuar, ajo fshihet kundrejt shumave te rikuperueshme dhe per to nuk njihen me te ardhurat nga interesi.

Te ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet rrjedhin nga sherbimet financiare te ofruara nga Banka si transferimi i fondeve, aktivite huadhenese, tarifat e mirembajtjes se llogarive dhe komisione te garancive bankare. Te ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet njihen kur sherbimet perkatese jane kryer.

3.8 Transaksionet spot te kembimit valutor

Banka gjate aktivitetit te saj te zakonshem hyn ne kembime valutore me data likuidimi 2 dite pas dates se veprimit. Keto veprime ne daten e transaksionit regjistrohen si zera jashte bilancit dhe ne daten e likuidimit rregjistrohen ne pasqyrat financiare.

Ne daten e gjenerimit te pasqyrave financiare transaksionet spot te veprimeve te kembimit valutor jane rivlersuar dhe rezultati fitim/humbje eshte njohur ne pasqyren e te ardhurave.

3.9 Zhvleresimi

Vlera kontabel e aktiveve te Bankes rishikohet cdo date bilanci per te percaktuar nese ekziston ndonje evidence zhvleresimi te aktiveve ne fjale. Nese nje indikacion i tille ekziston, atehere percaktohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit dhe nese kjo vlere eshte me e vogel se vlera kontabel e aktivitetit, njihen shpenzimet per zhvleresim te tij dhe regjistrohen ne pasqyren e te ardhurave e shpenzimeve te periudhes.

3.10 Qerate

Totali i pagesave te bera per qerate operationale njihen ne pasqyren e te ardhurave e shpenzimeve sipas metodës lineare pergjate jetes se qerases

3. PERMBLEDHJE E PARIMEVE KONTABEL ME TE RENDESISHME (VAZHDIM)

3.11 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin e vitit permban tatimin e vitit aktual dhe ate te shtyre. Tatimi mbi fitimin njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve te periudhes me perjashtim te rasteve qe lidhen me zera qe njihen direkt ne kapital.

Tatimi i vitit aktual eshte tatimi qe pritet te paguhet per fitimin e tatueshem te vitit, duke perdorur normat e tatimit ne fuqi ne daten e bilancit, dhe çdo sistemim te tatimit te pagueshem per vitet e meparshme.

Tatimi i shtyre eshte llogaritur duke perdorur metoden e pozicionit financiar, nga diferencat e perkohshme ndermjet vleres kontabel neto te aktiveve dhe detyrimeve per qellime raportimi financiar dhe bazes tatimore. Tatimi i shtyre matet me normat e tatimit qe pritet te aplikohen ndaj diferencave te perkohshme kur ato kthehen mbrapsht bazuar ne ligjet qe jane ne force ne daten e raportimit.

Nje aktiv tatimor i shtyre njihet per aq sa eshte e mundur qe fitimi i tatueshem i ardhshem do te jete i disponueshem kundrejt te cilit diferencat e perkohshme te zbritshme te mund te perdoren. Tatimi i shtyre rishikohet ne çdo date raportimi dhe zvogelohet deri ne masen qe nuk ka me mundesi qe perfitimi nga tatimi mund te realizohet.

3.12 Aplikimi i standardeve te reja dhe te rishikuara

3.12.1 Standarde dhe Interpretime ne fuqi ne periudhen raportuese

Ndryshimet e mëposhtme të standardeve ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare janë në fuqi për periudhën raportuese:

- **SNRF 1 (i rishikuar) “Aplikimi për herë të parë i SNRF”** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 korrik 2009 ose pas kësaj date),
- **SNRF 3 (i rishikuar) “Kombinimet e Biznesit”** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 korrik 2009 ose pas kësaj date),
- **Rishikim i SNRF 1 “Aplikimi për herë të parë i SNRF”** – Përjashtimet shtesë për herën e parë të zbatimit. (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 janar 2010 ose pas kësaj date),
- **Rishikim i SNRF 2 “Pagesa të Bazuara në Aksione”** – Grup transaksionesh për pagesë aksionesh të shlyer në mjete monetare (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 janar 2010 ose pas kësaj date),
- **Rishikimi i SNK 27 “Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale”** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 korrik 2009 ose pas kësaj date),
- **Rishikim i SNK 39 “Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja”** – Artikujt mbrojtës të pranueshëm. (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 korrik 2009 ose pas kësaj date),
- **Ndryshimet në disa standarde dhe interpretime “Përmirësimet e IFRS-ve (2009)”** që rezultojnë nga projektet vjetore për përmirësimet në cilësi të SNRF-ve të publikuara më 16 prill 2009 (SNRF 2, SNRF 5, SNRF 8, SNK 1, SNK 7, SNK 17, SNK 18, SNK 36, SNK 38, SNK 39, KIRFN 9, KIRFN 16) kryesisht me qëllim heqjen e paqëndrueshmërive dhe përmirësimin e tekstit (shumica e rishikimeve do të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë në 1 janar 2010 ose pas kësaj date),

3. PERMBLEDHJE E PARIMEVE KONTABEL ME TE RENDESISHME (VAZHDIM)

3.12.1 Standarde dhe Interpretime ne fuqi ne periudhen raportuese (vazhdim)

- **KIRFN 17 “Shpërndarja e Aktiveve Jo-monetare ndaj Pronarëve”** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 korrik 2009 ose pas kësaj date),
- **KIRFN 18 “Transferimi i Aktiveve nga Klientët”** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 korrik 2009 ose pas kësaj date), [duke supozuar se një transferim i tillë i aktiveve nuk ka ndodhur në gjysmën e dytë të vitit 2009 dhe se Shoqëria e ka aplikuar KIRFN 18 për herë të parë në 2010].

Këto ndryshime në standardet dhe interpretime ekzistuese nuk kanë ndikuar në politikat kontabël, pozicionin financiar dhe performancën e Bankës.

3.12.1 Standarde dhe interpretime në publikim akoma në fuqi

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare të veçanta standardet, përmirësimet dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar por akoma në fuqi. Asnjë prej tyre nuk pritet të ketë efekt të ndjeshëm në pasqyrat financiare të Bankës, përveç SNRF 9 *Instrumentat Financiarë*, i cili bëhet i detyrueshëm për t'u zbatuar në pasqyrat financiare të Bankës në 2013, dhe mund të ndryshojë klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare. Banka nuk parashikon ta zbatojë këtë standard më herët dhe niveli i impakti i tij nuk është vlerësuar ende.

- **SNRF 9 “Instrumentet Financiare”** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 janar 2013 ose pas kësaj date). SNRF 9 “Instrumentet Financiare” u publikua nga BSNK më 12 nëntor 2009. Më 28 shtator 2010, BSNK ri-publikoi SNRF 9, duke shtuar kërkesa të reja mbi kontabilizimin e detyrimeve financiare dhe duke mbajtur nga SNK 39 kërkesat për çregjistrimin e aktiveve dhe detyrimeve financiare. Standardi përdor një metodologji të vetme për të përcaktuar nëse aktivi financiar matet me kosto të amortizuar apo me vlerë të drejtë, duke zëvendësuar rregullat e shumta në SNK 39. Metodologjia e SNRF 9 bazohet mbi mënyrën se si një Shoqëri manaxhon instrumentat financiare (sipas modelit të biznesit) dhe karakteristikat e rrjedhjes së parasë së kontraktuar të aktivitetit financiar. Standardi i ri gjithashtu kërkon përdorimin e një metode zhvlerësimi, duke zëvendësuar metodat e ndryshme të zhvlerësimit në SNK 39. Kërkesat e reja për kontabilizimin e detyrimeve financiare adresojnë problemin e luhatjeve në fitim humbjet që lindin kur lëshuesi zgjedh ta vlerësojë borxhin me vlerën e drejtë. BSNK vendosi të mbajë vlerësimin aktual me kosto të amortizuar për shumicën e detyrimeve, duke u kufizuar në ndryshimet e kërkuara për të adresuar problemet e vetë kreditimit. Me kërkesat e reja, Banka që zgjedh të vlerësojë një detyrim me vlerën e drejtë do paraqesë pjesën e ndryshimit në vlerën e drejtë si pasojë e ndryshimeve në rrezikun e kreditimit, në të ardhura të tjera përmbledhëse. SNRF 9 e publikuar pasqyron pjesën e pare të punës së BSNK në zëvendësimin e SNK 39 dhe lidhet me klasifikimin dhe matjen e aktiveve dhe detyrimeve financiare të përkufizuara nga SNK 39. Në faza të mëtejshme, Bordi do adresojë zhvlerësimin dhe mbrojtjen [hedge]. Përfundimi i projektit pritet në mes të 2011. Aplikimi i fazës së parë të SNRF 9 kryesisht do ketë efekt në klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare. Banka aktualisht po vlerëson efektin e aplikimit të SNRF 9, gjithsesi, efekti do varet nga aktivet që do ketë Banka në datën e aplikimit, ndaj aktualisht nuk mund të kuantifikohet efekti.

3. PERMBLEDHJE E PARIMEVE KONTABEL ME TE RENDESISHME (VAZHDIM)

3.12.1 Standarde dhe interpretime në publikim akoma në fuqi (vazhdim)

- **Rishikim i SNRF 1 “Aplikimi për herë të parë i SNRF”**- Përjashtimet e limituara për shifrat krahasuese sipas SNRF 7; për paraqitjet për herën e parë të zbatimit (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2010 ose pas kësaj date),
- **Rishikim i SNRF 1 “Aplikimi për herë të parë i SNRF”**- Hiperinflacion i rëndë dhe heqja e datave të përcaktuara për herën e parë të zbatimit (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 korrik 2011 ose pas kësaj date),
- **Rishikimi i SNRF 7 “Instrumentet Financiare: Paraqitja”** –Transferimi i aktiveve financiare (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 korrik 2011 ose pas kësaj date),
- **Rishikimi I SNK 12 “Tatimet mbi të ardhurat”** – Taksa e shtyrë: Rimarrja e aktivitet bazë (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 janar 2012 ose pas kësaj date),
- **Rishikim i SNK 24 “Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Palët e Lidhura”** – Thjeshtësimi i kërkesave për paraqitjet e entiteteve të lidhura me qeverinë dhe qartësimi i përkufizimit të palëve të lidhura. (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 janar 2011 ose pas kësaj date),
- **Rishikim i SNK 32 “Instrumentet Financiare: Paraqitja”** – Kontabilizimi i të drejtave për të emetuar (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 shkurt 2010 ose pas kësaj date)
- **Ndryshimet në disa standarde dhe interpretime “Përmirësimet e IFRS-ve (2010)”** që rezultojnë nga projektet vjetore për përmirësimet në cilësi të SNRF-ve të publikuara më 6 maj 2010 (SNRF 1, SNRF 3, SNRF 7, SNK 1, SNK 27, SNK 34, KIRFN 13) kryesisht me qëllim heqjen e paqëndrueshmërive dhe përmirësimin e tekstit (rishikimet do të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë në 1 korrik 2010 ose pas kësaj date ose në 1 janar 2011 se pas kësaj date në varësi të standardit / interpretimit),
- **Rishikim i KIRFN 14 “SNK 19 — Limiti i Aktivitet për përfitime të përcaktuara, Kërkesat minimale për fonde dhe ndërveprimet e tyre.** – Parapagimet e një minimumi të kërkesës për fonde (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 janar 2011 ose pas kësaj date),
- **KIRFN 19 “Shuarja e Detyrimeve me instrumente Kapitali”** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 korrik 2010 ose pas kësaj date).

Banka ka zgjedhur të mos aplikojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre dhe parashikon se adoptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të saj në periudhën e aplikimit fillestar.

3.12.3 Krahasueshmeria

Informacioni krahasues është paraqitur në mënyrë konsistente duke aplikuar politikën kontabel të Bankes.

4. GJYKIMET KONTABEL DHE BURIMET KRYESORE TE PASIGURISE SE VLERESIMEVE

Ne aplikimin e politikave kontabel te Bankes te cilat u pershkruan ne shenimin 3, drejtimit i eshte kerkuar te beje gjykime, vleresime dhe supozime rreth vlerave te aktiveve dhe pasiveve te cilat nuk jane te gatshme nga burime te tjera. Vleresimet dhe supozimet e lidhura me to jane te bazuara mbi eksperiencen historike dhe faktore te tjere qe jane konsideruar te rendesishem. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto vleresime.

Vleresimet dhe supozimet e lidhura me to rishikohen vazhdimisht. Rishikimet ndaj vleresimeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen ndodh rishikimi nese ky rishikim prek vetem ate periudhe, ose periudhen ne te cilen ndodh rishikimi dhe periudhat e ardhshme ne rast se ky ndikon ne periudhat aktuale dhe ato te pritshme.

4.1 *Humbjet nga zhvleresimi i huave dhe paradhenieve te klienteve*

Banka rishikon portofolin e saj per te vleresuar zhvleresimin te pakten ne baza tremujore. Ne percaktimin nese duhet te rregjistrohet humbje nga zhvleresimi ne pasqyren permbljedhese te ardhurave, banka gjykon nese ka te dhena te dukshme te cilat tregojne nje renie ne pagesat e pritshme ne te ardhmen. Kjo deshmi mund te permbaje te dhena te cilat tregojne nje perkeqesim te mundesise per te paguar te disa kredimarresve ne nje grup apo kushtet ekonomike te cilat lidhen me standartet e aktiveve ne grup. Banka perdor vleresime bazuar ne eksperiencat historike te humbjes te aktiveve me karakteristika te rrezikut dhe evidencave objektive te zhvleresimit te ngjashme me ato te portofolit kur skedulon pagesat e pritshme te tij. Metodologjia dhe supozimet te perdoruara per te vleresuar shumen dhe kohen e pagesave te pritshme, rishikohen rregullisht per te zvogeluar diferencat midis humbjes se vleresuar dhe asaj te ndodhur.

4.2 *Investime te mbajtura ne maturim*

Banka ndjek udhezimet e SNK 39 per te klasifikuar aktivet financiare jo derivative me pagesa fikse dhe maturim te vendosur si “ te mbajtura ne maturim”. Ky klasifikim kerkon gjykim te konsiderueshem. Ne kryerjen e ketij gjykimi, Banka vlereson qellimin per t’i mbajtur ne maturim keto investime. Nese Banka nuk ia del ne kete qellim per t’i mbajtur keto investime deri ne maturim pervec rasteve specifike-per shembull, shitja e nje pjese te pakonsiderueshme ne prag te maturimit- atehere kerkohet qe e tere kjo kategori te riklasifikohet si “ te vlefshme per shitje”. Investimet ne kete rast do te mateshin me metoden e vleres se drejte dhe jo me koston e amortizuar. Vleresimi i vleres se drejte te bonove te thesarit dhe investimeve te mbajtura ne maturim eshte ne shenimin 32.

